

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7001
E enjte, 21 shtator 2023
Çmimi 0.40 €

Rama në Nju-Jork: Jemi një rast
mjaft i veçantë sepse jemi një
komb i vogël, por me dy shtete,
Shqipërinë dhe Kosovën | **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-JA NËPËRMJET AMBASADORIT TË VET NË KOSOVË I JEP MBËSHTETJE BE-së
SI NDËRMJETËSUESE E DIALOGUT KOSOVË - SERBI | **FAQE 4-5**

HOVENIERI: SHBA-ja KA BESIM NË BE-në SI NDËRMJETËSUESE E DIALOGUT KOSOVË - SERBI



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se kanë ka besim të plotë në Bashkimin Evropian si ndërmjetësues i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se ShBA-ja ka

besim edhe në emisarën e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, i cili është akuzuar nga kryeministri Albin Kurti për pozicionim kundër Kosovës. Hovenieri ka thënë se presin nga Kosova dhe Serbia të ecin përpara drejt zbatimit të marrëveshjes së Ohrit. Ndërsa

kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se Lajçaku në takimin e 14 shtatorit ka ndryshuar qasje në dialog. Duke i dalë në krah Kurtit, Konjufca ka thënë se ideja origjinale e dialogut është se nuk ka Asociacion pa njohjen e Kosovës nga Serbia

SPECIALJA REFUZON NËNTË KËRKESA PËR STATUSIN E VIKTIMAVE PJESËMARRËSE NË RASTIN E KRERËVE TË UÇK-së



BARDHYL MAHMUTI NË GJYKIMIN E PJETËR SHALËS: NË KUKËS KAM QENË VETËM NJË HERË | **FAQE 7**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



OSMANI TAKOHET ME BLINKENIN
NË NJU-JORK, BISEDOJNË
PËR TË ARDHMEN EUROATLANTIKE
TË KOSOVËS | **F. 3**

"GJUHA E URREJTJES NË KOSOVË,
NË RRIJTJE" | **F. 6**

ARRESTOHEN TRE SERBË TË
DYSHUAR PËR KRIME LUFTE NË
KOSOVË | **F. 7**

LIROHEN 36 TË AKUZUARIT NË
RASTIN "STENTA 2" | **F. 6**

EKONOMI



GAP-i: KOSOVA, 96 995 BIZNESE
AKTIVE | **F. 8**

KONFISKOHEN 30 AUTOMJETE TË
PAZHDOGANURA | **F. 8**

SPORT



BARDHI REXHA OPEROHET ME
SUKSES: RIKTHEHEM EDHE MË I
FORTË | **F. 12**

Meloni: Nuk do të lejojë që Italia të bëhet kamp i refugjatëve të BE-së

NJU-JORK, 20 SHTATOR - Kryeministrja italiane Giorgia Meloni, nga marginat e ceremonisë në OKB-së në të cilën ka vendosur një kurorë me lule në monumentin e Kristofor Kolombit në Nju-Jork, ka thënë se nuk do të lejojë që Italia të bëhet kampi i

refugjatëve të BE-së. Ndër të tjera, ajo ka theksuar se në këtë situatë është e rëndësishme që vendet t'u shpallin luftë trafikantëve të qenieve njerëzore. "Është e rëndësishme që memorandumimi me Tunizinë të vazhdojë, një model për t'u përdorur edhe me kombet e

tjera", ka thënë Meloni. Ndër të tjera, ajo ka shtuar se çështja nuk mund të zhvendoset nga një vend në tjetrin. "Çështja nuk është ajo e zhvendosjeve. Askush nuk mund të mendojë përballë këtyre flukseve për t'ia kaluar problemin diku tjetër", është shprehur Meloni.



Bideni i kërkon gjithë botës të bashkohet kundër Ruisisë

NJU-JORK, 20 SHTATOR - Presidenti amerikan, Joe Biden, u ka bërë thirrje liderëve botërorë të qëndrojnë afër Ukrainës teksa ajo po e lufton pushtimin rus, me shpresën se edhe republikanët në Kongresin amerikan do të mbajnë shënime. "Rusia beson se bota do të lodhet dhe do ta lejojë atë që të jetë brutale ndaj Ukrainës, pa ndonjë pasojë. Nëse e lejojmë Ukrainën të gërmohej, a është e sigurt pavarësia e ndonjë vendi?", ka thënë Bideni në fjalimin e mbajtur në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Bideni, demokrat, është duke bërë vazhdimisht thirrje që aleatët e Shteteve të Bashkuara ta mbështesin Ukrainën, me arsyetimin se bota duhet t'i dërgojë sinjal presidentit rus, Vladimir Putin, se ai nuk do të mund t'i bëjë ballë Perëndimit.

Fjalimi i tij është përcjell me duartrokitje kur ka thënë se Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë me Ukrainën në luftën e saj për liri. "Rusia është ajo që e mban përgjegjësinë për këtë luftë. Rusia e ka forcën që ta ndalë këtë luftë menjëherë", ka thënë ai.

Bideni është përballur me kritika nga disa republikanë, të cilët dëshirojnë që Shtetet e Bashkuara të shpenzojnë më pak para për këtë luftë.

Ish-presidenti amerikan, Donald Trump, kandidati kryesor për ta fituar nominimin e republikanëve për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024, është



zotuar se do t'i japë fund luftës me shpejtësi nëse kthehet në pushtet.

"E ardhmja jonë është e lidhur me tuajën"

Përgjatë fjalimit të tij, Bideni ka thënë se e kupton detyrën që e ka shteti i tij në këtë moment kritik për botën. "Shtetet e Bashkuara synojnë një botë më të sigurt dhe më të barabartë për të gjithë njerëzit, sepse ne e dimë që e ardhmja jonë është e lidhur me tuajën. Asnjë shtet nuk mund të përballë me sfidat e të sotmes, vetëm", ka thënë ai.

Menaxhimi i tensioneve ShBA - Kinë

Bideni e ka shfrytëzuar fjalimin e tij për të ofruar siguri për konkurrencën intensive në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kinës pas paralajmërimeve të disa ekspertëve se bota mund të përballë me një luftë të ftohtë. "Kur është fjala për Kinën, dua të jem i qartë dhe konsistent. Ne synojmë ta menaxhojmë konkurrencën mes dy vendeve me përgjegjësi, ashtu që të mos rrëshqasë në konflikt", ka thënë Bideni. Zëvendës-presidenti kinez, Han Zheng, është takuar të hënën

me sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, në margjinat të Asamblesë së OKB-së. Ky ka qenë takimi i dytë i nivelit të lartë mes dy vendeve, disa ditë pasi fuqitë botërore kanë thënë se synojnë që tensionet t'i mbajnë nën kontroll.

Mes të tjerash, presidenti amerikan ka thënë se intelijenca artificiale duhet të jetë "e sigurt" para se në të të ketë qasje publiku. Ai ka thënë se qeveritë duhet ta menaxhojnë këtë teknologji dhe jo e kundërta. "Ne duhet të sigurohemi që i përdorim këto pajisje si diçka që na rritin

mundësitë, dhe jo si armë për shtypje", ka thënë Bideni.

Javën e kaluar liderët e teknologjisë, Elon Musk dhe Mark Zuckerberg, janë takuar në Kongresin amerikan për të biseduar për rregulloret teknologjike.

"Ndryshimet klimatike, kërcënim ekzistencial"

Bideni ka thënë se Shtetet e Bashkuara janë duke i trajtuar ndryshimet klimatike si "kërcënim ekzistencial". Duke i renditur disa katastrofa natyrore - valë të të nxehtit në Shtetet e Bashkuara dhe Kinë, zjarret pyjore në ShBA dhe Evropë, thatësinë në Afrikë dhe përmbytjet në Libi - Biden ka thënë se këto të gjitha së bashku japin shenjë se çfarë e pret botën nëse nuk ulet varësia nga lëndët djegëse të papërpunuara. "Prej ditës së parë të administratës sime në Shtetet e Bashkuara, kjo krizë është trajtuar si kërcënim ekzistencial jo vetëm për ne, por për gjithë njerëzimin", ka thënë ai.

Për shkak të pranisë së madhe të figurave publike në asamble, ky organizim shihet edhe si mundësi që liderët të mbajnë takime me njëri-tjetër. Megjithatë, në Asamblenë e këtij viti nuk marrin pjesë: presidenti francez Emmanuel Macron, presidenti kinez Xi Jinping, presidenti rus Vladimir Putin dhe kryeministri britanik Rishi Sunak.

Lufta në Ukrainë, humbjet e Ruisisë janë rritur ndjeshëm

UASHINGTON, 20 SHTATOR - Humbjet ruse janë "rritur ndjeshëm" në Zaporizhzhia perëndimore ditët e fundit, sipas Institutit për Studimin e Luftës (ISW).

Grupi i ekspertëve me bazë në ShBA ka thënë se ushtria ruse "ka të ngjarë të luftojë me

mungesën e njëjësive efektive luftarake të disponueshme që komanda ruse është e gatshme t'i ridislokojë anash në këtë sektor të frontit".

Analiza e ISW-së ka theksuar se burimet ruse dhe ukrainase "e kreditorin koordinimin e lartë luftarak

ukrainas, zjarrin më preciz të artilerisë dhe sistemet më të forta të luftës elektronike për përparimet e fundit ukrainase në jug të Bakhmutit, mes diskutimeve të vazhdueshme për humbje të konsiderueshme ruse në zonë".



Osmani kërkon përshtetimin e rrugës së Kosovës në BE

Nju-Jork, 20 shtator - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila po qëndron në Nju-Jork, ku po mbahet sesioni i 78-të i Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, ka marrë pjesë në një drekë të organizuar nga përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për punët e jashtme dhe politikën e sigurisë, Josep Borrell. Në këtë takim është diskutuar për

bashkëpunimin rajonal dhe përshtetimin e procesit të integritimit evropian për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Presidentja Osmani ka shtuar nevojën e përshtetimit të procesit dhe marrjen e vendimeve të nevojshme nga ana BE-së për integritimin e Kosovës, duke i dhënë statusin e vendit kandidat, si dhe anëtarësimin e shteteve të rajonit

bazuar në përmbushjen e kriterëve. Osmani, po ashtu, ka theksuar se masat e BE-së ndaj Kosovës, përveç që nuk i kontribuojnë avancimit të dialogut, ato nëpërmjet pezullimit të projekteve të BE-së, më së shumti prekin interesat dhe mirëqenien e qytetarëve. Në këtë kontekst, presidentja Osmani tha e Kosova është palë

konstruktive dhe e përkushtuar për paqe dhe stabilitet, e bashkërenduar tërësisht me politikën e BE-së edhe sa i përket sanksioneve dhe me procese reformuese të rëndësishme. "BE duhet t'i shpërblejë shtetet të cilat janë të bashkërenduara me BE-në dhe në të njëjtën kohë



kanë ndërmarrë reforma, sidomos në sundimin e ligjit, ekonomi dhe standarde evropiane", ka theksuar presidentja Osmani.

Kosova, prioritet i Shqipërisë në politikën e jashtme

Tiranë, 20 shtator - Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me ftesë të kryetares së Komisionit për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Mimi Kodheli, ka realizuar një vizitë zyrtare në Tiranë.

Delegacioni i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, i kryesuar nga Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e komisionit, së bashku me anëtarët Xhavit Haliti, Yllza Hoti dhe Time Kadrijaj, gjatë vizitës zyrtare në Tiranë kanë takuar në Komisionin për Politikën e Jashtme, Komisionin për Çështjet Evropiane, deputetë dhe përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë në organizata ndërkombëtare si zëvendësministren e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Artemis Malo.

Takimi i parë i anëtarëve të këtij komisioni ishte me komisionin homolog, atë për politikën e jashtme. Gjatë këtij takimi është vlerësuar roli i Shqipërisë në mbështetjen e Kosovës në të gjitha etapat e shtetndërtimit të saj. Nga pala shqiptare është theksuar se Kosova është prioritet i Republikës së Shqipërisë për njohje të plotë ndërkombëtare dhe për integrim në organizata ndërkombëtare. Po



ashtu, në këtë takim është biseduar për situatën në të cilën gjendet Kosova si pasojë e dialogut Kosovë - Serbi dhe për mundësitë e daljes nga kjo situatë në të mirën e Kosovës. "Procesi i Berlinit është kthyer në qendër të vëmendjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së dhe gjatë takimit të komisioneve u konfirmua se ky është i vetmi proces që i ofron vendet e BP-së drejt integritimit në BE. Palët u pajtuan që të ngrihet niveli i bashkëpunimit në mes të komisioneve, u propozua nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi në mes të komisioneve për konkretizimin e aktivitetëve të përbashkëta", ka njoftuar Kuvendi i Kosovës. Ndërsa gjatë takimit me Komisionin për Çështjet Evropiane është thënë se procesi i liberalizimit të vizave i ka

humbur Kosovës shumë kohë dhe mund, por se tashmë ky proces është i përfunduar dhe se është caktuar data kur qytetarët e Kosovës mund të lëvizin pa viza në Bashkimin Evropian. "Pala shqiptare theksoi se në çdo takim ndërkombëtar çështje parësore që diskutohet është çështja e Kosovës. U theksua se Shqipëria dhe Kosova nuk duhet të presin projekte për të bashkëpunuar, por bashkëpunimi në mes të dy vendeve duhet të jetë i domosdoshëm, i përditshëm dhe se bashkëpunimi është e vetmja rrugë drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës ishte gjithashtu çështje diskutimi. U potencua se në këtë proces nevojitet lobim i fortë, sidomos me vendet hezituese

brenda KE-së, që të votojnë për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë", ka njoftuar Kuvendi.

Sipas këtij njoftimi, në takimin me delegacionet e përhershme të Kuvendit të Shqipërisë në organizata ndërkombëtare parlamentare është thënë se agenda e Republikës së Shqipërisë në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) është përshtetimi i anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës. "U nda mendimi i përbashkët se delegacioni i Shqipërisë dhe i Kosovës në këtë organizatë vepron si një delegacion i vetëm, përderisa u theksua nevoja për lobim të vendit mike të Kosovës të cilat e përkrahin anëtarësimin e Kosovës në KE. Krijimi i një strategjie të përbashkët veprimi është vlerësuar si e domosdoshme për avancimin e mëtejshëm në këtë proces, u tha në takim. Edhe pse Republika e Kosovës nuk është pjesë e Asamblesë Parlamentare OSBE PA, u theksua nevoja që Kosova të mos lë asnjë vend bosh dhe të marrë pjesë në çdo iniciativë ndërkombëtare. Kosova është përpjekur disa herë që të jetë pjesë e kësaj organizate edhe në cilësinë e mysafires, por asnjëherë nuk ka pasur rast të ftohet në ndonjërin nga

forumet e kësaj organizate", ka njoftuar Kuvendi.

Lidhur me Komitetin Parlamentar për Stabilizim Asociim (KPSA), delegacioni shqiptar ka njoftuar se i përcjell negociatat që Republika e Kosovës ka me Komisionin Evropian dhe se është në dispozicionin e Kosovës për çfarëdo asistence që Kosova ka nevojë lidhur me këtë proces.

Ndërsa gjatë takimit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, zëvendësministria Artemis Malo, e cila mbulon dikasterin e diasporës brenda ministrisë, tha se Kosova në këtë drejtim ka bërë hapa të suksesshëm në integritimin e diasporës brenda jetës politike në Kosovë.

Nga delegacioni i Kosovës është bërë me dije se dy vendet mund të rritin bashkëpunimin në fushën e diasporës dhe se në këtë drejtim mund të shkëmbehen përvojat. "U kërkua nga Republika e Shqipërisë ta shfrytëzojë rastin me kryesimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së të llojë të shtetet skeptike në mënyrë që gjërat të lëvizin në favor të Kosovës. Theks të veçantë u kërkua t'u kushtohet pesë vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur ende Republikën e Kosovës", ka njoftuar Kuvendi.

Rama në Nju-Jork: Jemi një rast mjaft i veçantë sepse jemi një komb i vogël, por me dy shtete, Shqipërinë dhe Kosovën

NJU-JORK, 20 SHTATOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka marrë pjesë në takimin vjetor të "Iniciativës Globale Clinton" që është mbajtur në Nju-Jork. Aty ai ka folur për ngjarje prej asaj të dhënies së ndihmës afganëve, por edhe punën që do ta bëjnë në Këshillin e Sigurimit. Gjithashtu, Rama ka përmendur edhe Kosovën para të ftuarve në kontekstin se "ne jemi një rast mjaft i veçantë sepse jemi një komb i vogël, por me dy shtete, Shqipëria dhe Kosova dhe shqiptarët jetojnë kudo".

"Gjithë këta persona që kishin punuar për ne dhe kur flas për ne është sepse Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe ka qenë pjesë e



misionit atje dhe çfarë do të ndodhte me të gjithë këta njerëz të cilët ishin ekspozuar si armiq të ardhshëm të regjimit të ri aty. Duke u besuar ëndrrave që ne shitëm, duke i besuar të ardhmes që ne bëjmë të ëndërronin. Më pas morëm disa kërkesa krejt befasisht nga

disa prej organizatave të përfshira, gjithashtu edhe nga senatorja Clinton, gjithashtu edhe nga të tjerë për t'i pritur këta njerëz në Shqipëri. Po, nuk jemi mes më të mëdhenjve e mes më të pasurve, por duhet t'u hapnim dyert këtyre njerëzve sepse ishte turp t'i linim në

duart e këtyre barbarëve. Prej asaj kohe mësuam se sa e rëndësishme ishte që të kishim diçka më sistimore, më të gatshme për t'u përgjigjur dhe jo për të parë gjithë këtë kaos. Ne besojmë në Shqipëri që jemi kaotikë, por kur pashë se sa kaotike mund të ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, thashë: 'o Zot sa mirë jemi', ka thënë Rama, duke shtruar se Shqipëria dhe Kosova janë një komb.

Në këtë kontekst, ai ka sjellë në kujtesë kohën kur Shqipëria ishte përballuar me tërmetin e 29 nëntorit të vitit 2019 dhe ndihmën e shumë vendeve. "Kur u goditëm nga tërmeti qemë të bekuar se patëm miq dhe nuk na lanë vetëm as Bashkimi Evropian, as Turqia, nga Emiratet e Bashkuara Arabe

dhe nga shumë të tjerë të cilët na ndihmuan ndërkohë që qysh prej momentit të parë ishte e jashtëzakonshme t'i shihje ekipet e shpëtimit të vinin nga mbarë Evropa, madje dhe nga Izraeli, për të të ndihmuar për shpëtimin e njerëzve që ishin ende gjallë nën rrënoja. Po kështu ishte e jashtëzakonshme të shihje shqiptarët nga të gjitha vendet ku jetojmë, sepse ne jemi një rast mjaft i veçantë sepse jemi një komb i vogël, por me dy shtete, Shqipëria dhe Kosova dhe shqiptarët jetojnë kudo dhe ju e dini ndoshta më mirë se unë se në qoftë se doni të hani mirë, shkoni në një restorant të mirë shqiptar në Nju-Jork dhe gjithë ndihma prej tyre ishte e jashtëzakonshme", ka thënë Rama.

Osmani takohet me Blinkenin në Nju-Jork, bisedojnë për të ardhmen euroatlantike të Kosovës

Nju-Jork, 20 shtator - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar në Nju-Jork sekretarin amerikan të Shtetit, Antony

Blinken. Osmani ka shkruar në "Facebook" se me Blinkenin ka biseduar për të ardhmen euroatlantike të Kosovës.

"Diskutim i rëndësishëm me sekretarin Blinken për të ardhmen euroatlantike të Kosovës, fuqizimin

ndërkombëtar të vendit tonë, stabilitetin në rajon, si dhe rëndësinë e bashkërendimit me aleatët", ka shkruar Osmani.





SHBA-JA NËPËRMJET AMBASADORIT TË VET NË KOSOVË I JEP MBËSHTETJE BE-së
SI NDËRMJETËSUERE E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

Hovenieri: ShBA-ja ka besim në BE-në si ndërmjetësuese e dialogut Kosovë - Serbi

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se kanë ka besim të plotë në Bashkimin Evropian si ndërmjetësues i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se ShBA-ja ka besim edhe në emisarën e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, i cili është akuzuar nga kryeministri Albin Kurti për pozicionim kundër Kosovës. Hovenieri ka thënë se presin nga Kosova dhe Serbia të ecin përpara drejt zbatimit të marrëveshjes së Ohrit. Ndërsa kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se Lajçaku në takimin e 14 shtatorit ka ndryshuar qasje në dialog. Duke i dalë në krah Kurtit, Konjufca ka thënë se ideja origjinale e dialogut është se nuk ka Asociacion pa njohjen e Kosovës nga Serbia

palët, gjë që është pritja jonë, është rruja përpara. Kjo e sjell Kosovën më afër vizionit që ne ndajmë për integrimin e plotë në strukturat euroatlantike”, ka thënë Hovenieri.

Konjufca: Asociacioni bashkë me njohjen, çelës për përparimin e dialogut

Lidhur me procesin e dialogut të mërkurën ka folur edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Galuk Konjufca. Ai ka thënë se deklaratat e kryeministrit Albin Kurti ditë më parë nuk kanë qenë akuza, por konstatime për mënyrën e punës së emisarit të Bashkimit Evropian (BE) për dialogun, Miroslav Lajçak. Sipas Konjufcës, Lajçaku me qëndrimet e tij është pozicionuar në anën e Serbisë. Ai ka theksuar se në takimin e fundit ka ndryshuar qasje në dialog, duke shtuar se njohja është hequr dhe është kërkuar nga Lajçku vetëm formimi i Asociacionit.

I pyetur për qëndrimin e BE-së dhe të ShBA-së në lidhje me mbështetjen e tyre për punën e Lajçakut, Konjufca ka thënë se ka vetëm një çelës që dialogu të vazhdojë, e ai është që Asociacioni të formohet bashkë me njohjen nga Serbia.

Konjufca është shprehur i bindur se Kosova nuk mund të ecë asnjë hap përpara në procesin e dialogut nëse nuk e ka në horizont njohjen nga Serbia. Në këtë kontekst, ai ka thënë se me këtë premtim Vetëvendosja ka ardhur në pushtet. “Së pari nuk mendoj që ato ishin akuza. Ishin disa konstatime për mënyrën e punës së Lajçakut. Është vërejtur, thënë të drejtën qysh në fillim, se Lajçaku qëndrimet të cilat i artikulon më shumë janë, lë të themi, marrje e pozicionit të Serbisë fillimisht e pastaj përpjekje që përmes mekanizmave të ndryshëm dhe formulimeve që ai i qetë në zgjidhjet që i propozon, me mund me qenë pikënisje e pozicionit të Serbisë, qysh me mundur me

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë besim të plotë në Bashkimin Evropian (BE) sa i përket ndërmjetësimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, ka deklaruar ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, gjatë një fjalimi të mbajtur në edicionin e dytë të Samitit të Paqes dhe Demokracisë që po mbahet në Prishtinë. “ShBA-ja ka

besim të plotë në BE-në në ndërmjetësimin e saj të dialogut. ShBA-ja ka besim të plotë në përfaqësuesin e lartë të BE-së, Josep Borrell dhe në përfaqësuesin e posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, si zbatues objektivë të kësaj politike”, ka thënë Hovenieri. Deklarata e Hovenierit vjen dy ditë pasi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë akuza ndaj Miroslav Lajçakut, të cilin e ka cilësuar ndërmjetësues të njëanshëm. Më tutje, Hovenieri ka thënë se ka

kërkuar nga Kosova dhe Serbia ta pranojnë procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Po ashtu, ai ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia ta zbatojnë marrëveshjen e Ohrit. “Është e rëndësishme që të gjithë aktorët në këtë operacion, në këtë proces, të pranojnë procesin në të cilin janë dhe të luajnë poker me letrat që u kanë rënë. Dhe të kenë në mendje këtë vizion, puna për normalizimin e raporteve, për zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit dhe të Aneksit, nga të dyja

Qeveria dhe BE-ja nuk pajtohen për Asociacionin

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Përkundër thirrjes së përsëritur të Bashkimit Evropian (BE) që Kosova ta nisë punën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Qeveria e Kosovës nuk është shprehur e gatshme të ndërmarrë hapa në këtë drejtim, së paku jo tash për tash.

BE-ja ka kërkuar që puna për themelimin e këtij asociacioni të nisë "pa vonesa të reja".

Shefi i politikës së jashtme të bllokut evropian, Josep Borrell, ka përsëritur se Kosova dhe Serbia duhet ta zbatojnë marrëveshjen bazë për normalizimin e marrëdhënieve bazuar në propozimin e BE-së.

Ky propozim kërkon që zbatimi të nisë me "hapjen e procesit negociues për statutin e instrumenteve për vetëmenaxhim të serbëve në Kosovë", që nënkupton Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Propozimi është dhënë në raundin e fundit të bisedimeve midis Kosovës dhe Serbisë që është mbajtur javën e kaluar në Bruksel por që, sipas diplomatëve të BE-së, është refuzuar nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe është pranuar nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Në një deklaratë me shkrim dhënë "Radios Evropa e Lirë", zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, ka thënë se "është gabim të vendosësh kushtëzime" për zbatimin e marrëveshjes bazë, kur as në tekstin e kësaj marrëveshjeje "nuk paraqiten kushtëzime".

"Marrëveshja bazë duhet të zbatohet në tërësi, pa vonesa, pa kushte. Madje, edhe në aneksin (e zbatimit të marrëveshjes) thuhet qartazi se të gjitha nenet zbatohen

pavarësisht njëri-tjetrit", ka thënë Kryeziu.

Marrëveshja në fjalë është arritur në muajin shkurt në Bruksel, ndërsa për aneksin e zbatimit të saj palët janë pajtuar në muajin mars në Ohër.

Marrëveshja me 11 nene parasheh, mes të tjerash, një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të dialogut.

Për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje qysh në vitin 2013. Përkundër kërkesave të vazhdueshme të ndërkombëtarëve dhe të Serbisë, Kosova nuk e ka zbatuar kurrë atë marrëveshje, nga frika se mund të ndikojë në funksionalitetin e shtetit Kurti, në disa raste, ka thënë se nuk mund ta lejojë themelimin e një asociacioni njëetnik, i cili do të kishte kompetenca ekzekutive siç kërkon Beogradi.

Pas përfundimit të bisedimeve pa ndonjë rezultat, javën e kaluar Kurti ka thënë se "kushtëzimi i Serbisë" për formimin e Asociacionit "është shndërruar në qëndrim të emisarëve të BE-së". Duke folur në një konferencë me gazetarë një ditë më herët, ai tha se i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, është "pozicionuar kundër Kosovës" në takimin e 14 shtatorit.

Kurti, po ashtu, ka thënë se në ditët në vazhdim do të ketë takime me "të gjithë faktorët ndërkombëtarë të cilët e kanë pranuar shtetin e Kosovës". BE-ja ka thënë se nuk i

komenton "akuzat e pabaza" të Kurtit.

"REL"-i e ka pyetur Kryeziun nëse Kurti do t'i përgjigjet ftesës së BE-së për një raund të ri bisedimesh me Vuçiqin, po qe se ka një të tillë, por ai nuk ka komentuar.

Ruge: BE-ja ta ndryshojë fokusin

Majda Ruge nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë ka thënë se nuk beson se Kurti po ua mbyll dyert takimeve të ardhshme me përfaqësuesin e posaçëm të BE-së, por po përvetëson, sipas saj, një taktikë që do ta bëjë më të vështirë për BE-në ta vazhdojë qasjen e tanishme.

Kjo qasje, ka thënë Ruge, konsiston me "ushtrimin e gjithë trysnisë mbi palën më të dobët, për ta zbatuar marrëveshjen për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërkohë që nuk kërkon pothuajse asnjë lëshim nga Serbia në këmbim".

"Rrugëdalja - nëse përkufizohet si rivendosje e një procesi të ekuilibruar negociimi që ka shanse për të pasur sukses - është të ndryshohet fokusi. BE-ja nuk duhet ta legjitimojë idenë e një asociacioni si një njësi autonome de facto, gjë në të cilën këmbëngul Vuçiqi", ka thënë Ruge për "Radios Evropa e Lirë". Sipas saj, BE-ja "duhet të insistojë në zbatimin e sundimit të ligjit në veri të Kosovës" - ku popullata shumicë është serbe - dhe të promovojë një zgjidhje, e cila "siguron që pakica serbe në veri mund të ushtrojë një shkallë të mjaftueshme të autonomisë kulturore, arsimore dhe fetare". "Është e rëndësishme të



kuptohet se lloji i Asociacionit që kërkon presidenti i Serbisë, Vuçiq, nuk synon domosdoshmërisht t'i promovojë interesat kulturore dhe fetare të popullit serb në veri, por më tepër një mekanizëm institucional të kontrollit politik dhe të ndërhyrjes së Beogradit në punët e brendshme të Kosovës. BE-ja nuk duhet ta pranojë këtë", ka thënë Ruge.

Ker-Lindsay: Kurti të ofrojë diçka serioze

Por, për James Ker-Lindsay, profesor në Shkollën Ekonomike të Londrës, lëvizja e Kurtit është "shumë, shumë e rrezikshme për Kosovën" dhe "po i humb mbështetjet të madhe ndërkombëtare". "Nuk i besoj Lajçakut, nuk i besoj Borrellit. Do t'ju drejtohem direkt juve - shteteve anëtare... Çfarë duhet të bëjnë shtetet anëtare? A pret që ato ta shkarkojnë Lajçakun? A pret që ta shkarkojnë Borrellin? Jo", ka thënë Ker-Lindsay për "Radios Evropa e Lirë".

Duke thënë se këta dy diplomatë

vijnë nga shtete që nuk e njohin Kosovën - Sllovakia dhe Spanja - Kurti "dëshiron ta kënaqë audiencën e tij vendase" dhe "të luajë me kartën nacionaliste", shton ai. Sipas tij, Kurti duhet të ulët dhe të bisedojë për themelimin e Asociacionit, nëse "është vërtet i interesuar t'i rindërtojë marrëdhëniet me Bashkimin Evropian".

Kurti "duhet të dalë me një lloj plani për Asociacionin, por është e qartë se nuk do ta bëjë këtë dhe hyn në betejë me BE-në. Ai nuk do të dalë fitues diplomatik në këtë", ka thënë Ker-Lindsay.

Qeveria e Kosovës, më herët këtë vit, ka dalë me të ashtuquajturin "model kroat" për Asociacionin, por ai nuk ka shkuar përpara.

Ker-Lindsay ka thënë se "nëse Kurti ofron diçka vërtet serioze" në lidhje me Asociacionin, trysnia ndërkombëtare pastaj do të zhvendoset mbi Serbinë.

Serbia - aleate e Rusisë, por edhe vend kandidat për anëtarësim në BE - nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe angazhohet në fushata për mospranimin e saj në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

akomoduar në mënyrë sa më të përshtatshme pozicionimin e Serbisë", ka thënë Konjufca, duke shtuar se pozicioni i Serbisë është i qartë. "E cili është pozicionimi i Serbisë? Pozicionimi i Serbisë është që Kosova duhet ta bëjë një Asociacion jashtë çdo ombrelle politike të procesit i cili e ka arritur në këtë pikën ku jemi tash. Qasja origjinale ka qenë ndryshe krejt. Qasja origjinale ka qenë kjo që me qenë se Kosova nuk mund ta bëjë Asociacionin, sepse përndryshe do ta kishte bërë prej 2013-s, do ta kishte bërë në qeverinë e Isa Mustafës ose Hashim Thaçit. Tash me Vetëvendosjen është me vështirë që të bëhet. Sepse ne e kemi marrë një mandat goxha të fuqishëm politik me disa premtime të tjera. Cilat kanë qenë ato premtime? Ato kanë



qenë se Kosova nuk mund të ecë asnjë hap përpara në procesin e dialogut nëse nuk e ka në horizont njohjen nga Serbia. Duke e pasur

këtë parasysh, ekspertët që e kanë përpiluar marrëveshjen e Ohrit e kanë zgjeruar ombrellën. Zgjerimi i ombrellës është që aty të jenë

njohja dhe Asociacioni. Tash Lajçaku po thotë që aty është vetëm Asociacioni. Njohja i përket Serbisë kur të dojë ajo. Do të thotë ky është pozicioni i Serbisë. Nëse Lajçaku e artikulon atë dhe thotë që ky është pozicioni i Serbisë. Nëse Lajçaku e artikulon këtë dhe thotë që ky është pozicioni i BE-së, atëherë ne mund të themi që Lajçaku paska kontribuar që ky pozicion zyrtar i BE-së të jetë kjo që e përfaqëson Serbia. Mua nuk më duket kjo e drejtpeshuar fare. Është devijim prej idesë origjinale", ka thënë Konjufca. Sipas tij, ideja origjinale e dialogut është se nuk ka Asociacion pa njohje. "Nuk mundesh asociacion me marrë edhe me heq prej idesë së njohjes. Quajeni si doni. Njohja de-facto është njohje e shtetësisë së Kosovës. Serbia

duhet të pajtohet se kur ta kalojë kufirin në Merdar është në një shtet tjetër. Duhet ta njohë flamurin, simbolet. Nuk duhet të na pengojë kur aplikojmë në organizata ndërkombëtare. Pastaj është në përgjegjësinë e Kosovës të gjejë një formë të Asociacionit që është në përputhje me Kushtetutën dhe nuk e cenon rendin juridik. Nëse mundoheni me shkatërruar me të idenë, atëherë jeni në favor të Serbisë. Nuk është akuzë kjo. Ky është identifikim i një njeriu i cili po kryen punën e vet goxha në mënyrë të papërgjegjshme. Vetëm një çelës është i mundshëm për të ecur dialogu përpara: Asociacioni bashkë me njohjen, përndryshe nuk ka avancim të dialogut", ka thënë Konjufca.

Kurti në fundjavë viziton Zvicrën

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në fund të javës do ta realizojë një vizitë në kryeqytetin e Zvicrës, Bernë. Ai do të mirëpritet nga ministri i Brendshëm, Alain Berset, i cili mban presidencën e

radhës zvicerane këtë vit. Çështjet aktuale rajonale në Ballkanin Perëndimor dhe marrëdhëniet dypalëshe në mes të Zvicrës dhe Kosovës do të jenë temë diskutimi. Në mbrëmjen e vizitës së tij, Kurti do të zhvillojë një

takim në Ambasadën e Kosovës në Bernë me kandidatët shqipfolës për Dhomën e Përfaqësuesve, shkruan "Le Canton27.ch". Gjatë qëndrimit në Zvicër ai do të takohet edhe me mërgimtarë në disa kantone.



Lirohen 36 të akuzuarit në rastin "Stenta 2"

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj 36 të akuzuarve në rastin e njohur si "Stenta 2", lidhur me akuzat për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe marrje rryshfeti. Aktgjykimi ndaj tyre është shpallur të mërkurën nga kryetarja e trupit gjykues, Suzana Çerkini. Sipas aktgjykimit, 36 të akuzuarit: Gani Bajraktari, Afërdita Selmanaj, Hamza Selmani, Ismajl Avdimetaj, Sali Shala, Nehat Rexhepaj, Agron Besimi,

Petrit Ademaj, Bajram Mziu, Agron Leka, Driton Miftari, Besim Guda, Mirdi Strana, Shemsedin Shabollari, Fisnik Hima, Luan Pazhari, Galina Berisha, Bajram Preteni, Lulzim Kamberi, Faik Shatri, Ejup Pllana, Florim Sadiku, Halim Halili, Agim Krasniqi, Hajdin Çitaku, Edmond Haliti, Besnik Koliqi, Afrim Poniku, Banush Gashi, Nebih Musliu, Dardan Koqinaj, Xhevdet Krasniqi, Lazër Prekpalaj, Rexhep Manaj, Kelmend Pallaska dhe Arlind Batalli lirohen nga akuza pasi nuk është provuar se kanë kryer

veprat penale që u viheshin në barrë. Ndërsa në seancën e mbajtur më 17 gusht 2023, prokurorja speciale Florije Shamolli gjatë dhënies së fjalës përfundimtare kishte ndryshuar vlerën e dëmit nga 4 milionë e gjysmë në 11 mijë e 430 euro. Në rastin "Stenta 2" kanë qenë të përfshirë 45 mjekë, por për shkaqe shëndetësore, gjatë seancave të kaluara ishte veçuar procedura për të akuzuarit Elfedin Muhaxheri, Ferid Susuri, Ferihane Sefa, Masar Gashi, Murat Abazi dhe



Nexhmi Zeqiri. Po ashtu, për të akuzuarin Daut Gorani në seancën 16 gushtit 2023 është veçuar procedura për arsye

shëndetësore. Kurse për të akuzuarit S. Gj. dhe R. E ka pushuar procedura penale pasi ata kanë ndërruar jetë.

'Gjuha e urrejtjes në Kosovë, në rritje'

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Politikanët nuk kanë arritur të jenë shembull i mirë i luftimit të gjuhës së urrejtjes ka deklaruar të mërkurën kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në konferencën "Gjuha e urrejtjes në diskursin publik", ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar. Ai ka thënë se për këtë gjuhë, përgjegjësia bie mbi secilin përfaqësues politik që ta dënojë gjuhën e urrejtjes. Konjufca ka deklaruar se Kuvendi është në procedurën e hartimit të Kodit të Etikës, i cili do të ndihmojë për krijimin e praktikave demokratike të komunikimit.

Konjufca ka thënë se gjuha e urrejtjes është një fenomen global, i cili është duke sfiduar çdo shtet të botës. "Fatkeqësisht, ekzistojnë raste të shumta kur edhe politikanët nuk kanë arritur të jenë shembull i mirë i luftimit të gjuhës së urrejtjes në diskursin publik dhe ta ofrojnë atë shembull, atë model që duhet dhe ky është një model i cili promovon një gjuhë që promovon veçoritë e secilit individ, vlerat e tij, e sidomos të grupeve shoqërore, grupeve etnike, të grupeve identitare të ndryshme racore, fetare, seksuale e kështu me radhë. Një prej formave më të shprehura të dekurajimit për përfshirjen publike dhe politike, sidomos në grupet më të cenushme shoqërore, pra është gjuha e urrejtjes. Konsiderohet që përgjegjësia bie mbi secilin përfaqësues politik që jo vetëm ta dënojë gjuhën dhe e cila nxit urrejtje, por edhe t'i ftojë mbështetësit dhe qytetarët për tolerancë dhe mirëkuptim pavarësisht prej dallimeve që i kemi", ka thënë Konjufca. Pavarësisht prej legjislacionit, kryeparlamentari Konjufca ka thënë se përvoja e deritashme ka dëshmuar nevojën për përforsimin



e mekanizmave. "Kuvendi i Kosovës është në procedurën e hartimit të Kodit të Etikës. Ne ende si Kuvend nuk e kemi Kodin e Etikës. Jemi duke e përpiluar atë. Dhe ma merr mendja që më shumë do t'u ndihmojë përfaqësuesve të popullit për krijimin e praktikave demokratike të komunikimit. Dhe që ato të jenë më të kontrolluara, më të standardizuara dhe që të mos lejojmë përdorimin e shprehjeve të tilla, të cilat, më vjen keq, do të mund t'i keni dëgjuar edhe në Kuvendin e Kosovës", është shprehur ai. Ndërsa shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se gjuha e urrejtjes prek më së shumti grupet e ndryshme dhe se ky fenomen është i njëjtë me terrorizmin. "Për BE-në gjuha e urrejtjes dhe krimi i urrejtjes janë krime serioze sepse ndikojnë

shumë në të drejtat fundamentale të individëve, të shoqërisë në përgjithësi dhe minojnë edhe vetë themelin e shoqërisë tonë. Komisioni ka përfshirë edhe gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes në zgjerimin e krimeve të BE-së dhe që nga 2021 në dhjetor, gjuha e urrejtjes dhe krimi i urrejtjes do të jenë në të njëjtën grup të krimeve sikurse edhe terrorizmi, trafikimi i qenieve njerëzore, drogat e paligjshme, trafikimi i armëve e kështu me radhë. Gjuha e urrejtjes i prek më së shumti ata më të ndjeshmit, komunitetin LGBTI, rom, ashkali, egjiptas dhe komunitetet e tjera joshumicë, si dhe vajzat, gratë nga të gjitha komunitetet, personat me paaftësi dhe çfarëdo grupi tjetër që ndihet sikur në disavantazh apo i marginalizuar", ka thënë Szunyogu. Sipas tij, raportet rregullative të Kosovës kanë

ndërmarrë masat e duhura për ta adresuar gjuhën e urrejtjes. Me këtë rast, kryetari Glauk Konjufca ka përmendur edhe rastet kur është hasur gjuhë e urrejtjes në librat shkollorë, për çka tha se janë dëshmi që nuk ka pasur kontroll e as cilësi para se të publikohen. Për këtë çështje ka folur edhe Avokati i Popullit, Naim Qelaj, i cili ka thënë se janë analizuar 47 tekste shkollorë, ku është vërejtur në masë të madhe gjuha e urrejtjes. "Nëse i referohemi një analize të thjeshtë të diskutit të komunikimit publik sot në vendin tonë, unë mund të konstatoj se gjuha e urrejtjes në baza diskriminuese ndaj grave, personave LGBTI është në rritje dhe kjo kryesisht mbi bazën e seksit, gjinisë, identitetit gjinor të tyre. E kjo rritje vërehet dukshëm siç u tha edhe nga kryetari i Kuvendit, në rrjete sociale, si platforma që lehtësojnë qasjen

gjithëpërfshirëse të secilit dhe mundësinë të lehtë për të shprehur, pamenduar për pasojat që mund t'i ketë ajo që komentojnë në këto platforma", ka thënë Qelaj. Më tutje, ai ka thënë se janë në fazën përfundimtare të analizimit të gjuhës në diskursin publik ku, siç ka thënë ai, është vërejtur gjuhë e urrejtjes nga deputetët në debatet parlamentare për kodin civil. Në anën tjetër, drejtoresha e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut "YIHR", Marigona Shabiu, ka thënë se qytetarët janë vazhdimisht dëshmitarë të një kulture fyese të debatit në Kuvend. "Një gjuhë e tillë është kërcënim për vetë demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Historia ka treguar se gjuha e urrejtjes është një akt në serinë e akteve që shpeshherë rezultojnë në krime më të mëdha të urrejtjes dhe përbën rrezik për çdo shoqëri dhe qytetar. Rrezikshmëria e gjuhës së urrejtjes si një akt shumëfishohet kur ajo instrumentalizohet dhe përdoret nga vetë zyrtarët e liderët shtetërorë që bartin pushtet institucionel. Fatkeqësisht në jemi dëshmitarë të këtij fenomeni në vazhdimësi në Kosovë. Fillojmë me Kuvendin e Republikës së Kosovës, në këtë institucion që supozohet të jetë forum për promovimin e barazisë, lirisë së gjithëpërfshirjes, kemi dëgjuar të përdoret gjuhë e urrejtjes si diskriminuese, ashtu edhe pezhorative ndaj komuniteteve dhe individëve më të cenushtëm të shoqërisë tonë", ka thënë ajo. Edhe Shabiu ka përmendur seancën e 16 marsit ku është debatuar për kodin civil. Ai ka thënë se ka krijuar ndjenjë të frikës dhe pasigurisë për komunitetin LGBTI. Sipas saj, personat e njëjtë nuk po ndëshkohen dhe vazhdojnë të mbajnë pozita.

Policia e Kosovës asgjëson mbi 1 500 armë ilegale

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Policia e Kosovës ka asgjësuar të mërkurën disa armë ilegale të konfiskuara në raste të ndryshme gjatë këtij viti. Asgjësimi i tyre është bërë në kuadër të Programit Kosovor për

Siguri në bashkëpunim me UNDP-në. Zyrtarë të UNDP-së dhe të Policisë së Kosovës kanë theksuar se sa e nevojshme është të ketë një ambient të sigurt për qytetarët, duke potencuar se përdorimi i

tyre cenon sigurinë. Procesi i shkatërrimit përfshin shkrirjen e mbi 1 500 armëve të llojeve dhe kalibrave të ndryshme, të konfiskuara nga operacione të ndryshme të policisë në të gjithë territorin e Kosovës.



Arrestohen tre serbë të dyshuar për krime lufte në Kosovë

Prishtinë, 20 shtator - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka arrestuar tre persona të nacionalitetit serb, të dyshuar për krime lufte kundër popullatës civile në Kosovë. "Prokuroria Speciale njofton se tre (3) të arrestuarit akuzohen për veprën penale 'Krime të luftës kundër popullatës civile', veprime këto të

sanksionuara sipas nenit 142 dhe 22 të Kodit Penal të RSFJ, aktualisht e penalizuar me nenet 31 dhe 153 të KPRK-së, në kundërshtim me nenin 3 të përbashkët të 4 Konventave të Gjenevës, të datës 12 gusht 1949, të neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit 2 të datës 08 qershor 1977, shtojcë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të gjitha rregullat e ligjeve ndërkombëtare në

fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe kurdoherë e rëndësishme për vendimin e tanishëm të ligjeve vendore, zakoneve të luftës dhe konventave ndërkombëtare të Gjenevës dhe protokolleve shtesë", ka njoftuar Prokuroria Speciale e Kosovës. Me aktvendim të prokurorit të Prokurorisë Speciale tre të arrestuarit janë dërguar në ndalim për 48 orë.



Bardhyl Mahmuti në gjykimin e Pjetër Shalës: Në Kukës kam qenë vetëm një herë

Hagë, 20 shtator - Në gjykimin ndaj Pjetër Shalës në Gjykatën Speciale në Hagë, ka dëshmuar Bardhyl Mahmuti, një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në cilësinë e dëshmitarit të mbrojtjes së Shalës, Mahmuti ka komentuar vultat hyrëse-dalëse në pasaportën e tij për në Republikën e Shqipërisë për periudhën prill-qershor 1999. Këtë deklaram dëshmitari Mahmuti e ka bërë duke u përgjigjur në pyetjet e avokatit Jean-Louis Gilissen.

Mahmuti, lidhur me vulën e 22 prillit 1999, ka thënë se është vulë hyrëse nga aeroporti i Rinasit në Republikën e Shqipërisë, kurse vula e 11 prillit për të nënkupton vulën hyrëse në Portin e Durrësit. Më tutje, lidhur me vulën e tretë, ai tha se është vulë dalëse nga Republika e Shqipërisë, por se nuk mund ta identifikojë datën e saktë. "Mund ta them se dalja duhet të jetë nga fundi i muajit prill, se deri në qershor në përfundim të luftës nuk kam qenë në Shqipëri, sepse kam qenë në Zvicër, Gjermani, Francë dhe Belgjikë", ka thënë Mahmuti. Po ashtu, ai ka thënë se ka një lidhje në mes të vulës së Republikës së Sllovenisë e 21 prillit 1999 dhe vulës së Republikës së Shqipërisë më 22 prill 1999. Ai ka thënë se ka ardhur atëkohë në Shqipëri përmes Sllovenisë, andaj është i sigurt se vula e 22 prillit është vulë hyrëse për në Shqipëri.

Mahmuti ka sqaruar se ka qëndruar rreth një javë në Shqipëri, më pas është larguar nga fundi i prillit për në Zvicër.



Në vazhdim të dëshmisë së tij, dëshmitari ka treguar edhe dy dokumente të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë, të cilat, sipas tij, tregojnë se dëshmitari nuk është i përfshirë në listën e njerëzve që kanë hyrë apo kanë dalë nga Shqipëria. Për këtë, ai ka thënë se personat nuk janë regjistruar për arsye se në atë kohë një milion shqiptarë janë dëbuar nga forcat serbe, por shtoi se nuk kanë mundur të bëhen hyrje-dalje pa vula e që për këtë ka sjellë edhe dokumentet e udhëtimit.

Ndërsa Mahmuti ka thënë se në

Kukës ka qenë vetëm një herë në maj të vitit 1998.

"Nga qershori 1998 deri në qershor kur ka përfunduar lufta në Kosovë, asnjëherë s'kam qenë në Kukës, përveç në Tiranë dhe Durrës. Asnjë vend tjetër s'kam qenë gjatë periudhës 1 qershor 1998-12 qershor 1999", ka thënë dëshmitari Mahmuti.

Paraprakisht, ai ka treguar për shkollimin, kualifikimet e tij dhe të prindërve të tij dhe se e ka quajtur familjen e tij familje e angazhuar për realizimin e të drejtës kombëtare duke shtuar se kanë qenë të vetëdijshëm se diskriminimi hiqet përmes

angazhimit politik. Ai, po ashtu, ka thënë se duke qenë pjesë e Lëvizjes Popullore të Kosovës, ka qenë edhe në strukturat e UÇK-së. Mahmuti ka thënë se UÇK-ja nuk ka pasur karta anëtarësimi pasi nuk ka qenë parti politike dhe se i njëjti nuk ka pasur ndonjë nofkë. Lidhur me veprimtarinë e tij në kuadër të UÇK-së, i njëjti ka thënë se ka qenë i angazhuar në mbrojtjen politike të UÇK-së, për ta arsyetuar në rrafshin diplomatik domosdoshmërinë e luftës çlirimtare të UÇK-së. Mahmuti ka thënë se grupi diplomatik nuk ka pasur një seli në qytet apo shtet të caktuar, por se ka

udhëzuar në shtete të ndryshme për ta përfaqësuar luftën e UÇK-së si të drejtë dhe të qëndrueshme. Ai ka thënë se në periudhën qershor 1998-qershor 1999 ka shkuar në Francë, Gjermani, Angli, ShBA, Itali, Austri, Slloveni, Shqipëri, Belgjikë, Holandë e në shumë vende.

Ndërsa kur është pyetur nga avokati Gilissen për periudhën prill-qershor 1999, ai ka thënë se ka qenë një herë në Shqipëri dhe disa herë në Francë, Gjermani dhe Belgjikë për takime zyrtare. Pas kësaj, me kërkesë të avokatit Gilissen, seanca ka vazhduar në sesion privat.

Specialja refuzon nëntë kërkesa për statusin e viktimave pjesëmarrëse në rastin e krerëve të UÇK-së

HAGË, 20 SHTATOR - Gjykata Speciale i ka refuzuar si të parakohshme nëntë kërkesa për statusin e viktimave pjesëmarrëse në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, me arsyetimin se afati kohor për dorëzimin e këtyre kërkesave ka skaduar më 15 shkurt. "Trupi gjyqësor

refuzoi të merrte në konsideratë bazueshmërinë e këtyre kërkesave pasi afati kohor për dorëzimin e tyre në këtë çështje skadoi më 15 shkurt dhe nuk ishte treguar asnjë arsye e pranueshme për t'i konsideruar të vlefshme siç parashihet në Rregullën 9 (5) (b)", është thënë në njoftimin e Gjykatës Speciale.

Megjithatë, në këtë njoftim është thënë se trupi gjyqësor ka vënë në dukje se Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave mund ta ridorëzojë raportin me disa informacione shtesë. Por, së fundmi është pranuar një viktimitë tjetër që të marrë pjesë në proces gjyqësor. Deri më tash numri total i viktimave në këtë çështje ka arritur 141.



GAP-i: Kosova, 96 995 biznese aktive

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Gjithsej janë analizuar 96 995 biznese aktive nga 227 mijë e 759 biznese të regjistruara në Kosovë që prej vitit 2000 deri në mars 2023. Prej tyre 78.7 për qind janë në pronësi të burrave, 18 për qind në pronësi të grave, 2.3 për qind janë në bashkëpronësi të paktën të një gruaje, ndërsa për 1 për qind tjetër nuk dihet gjinia e pronarëve.

Në raportin "Profilet e bizneseve: ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë" të Institutit GAP është thënë se në Kosovë janë 33 003 biznese të shuara nga viti 2000 deri në mars 2023. Prej tyre, 64 për qind janë në pronësi të burrave, 12 për qind janë në pronësi të grave, 0.3 për qind janë në pronësi të paktën të një gruaje dhe për



23.7 të bizneseve nuk dihet gjinia e pronarëve/eve. Ky raport identifikon profilet e bizneseve në pronësi të grave dhe atyre të pakicave etnike, duke analizuar praninë e tyre në Kosovë sipas madhësisë së biznesit, vendndodhjes gjeografike dhe sektorit ekonomik në të cilin ato

operojnë. Për më tepër, raporti analizon jetëgjatësinë e bizneseve në pronësi të grave krahasuar me bizneset në pronësi të burrave. "Raporti tregon se bizneset mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë 99 për qind të numrit të përgjithshëm të bizneseve në pronësi të grave

në Kosovë. Nga bizneset e analizuar, 5 253 prej tyre janë në pronësi të individëve të pakicave etnike në Kosovë: 30 për qind serbë, 28 për qind turq, 10.5 për qind boshnjakë, 2.7 për qind goranë, 2 për qind ashkali, 1.7 për qind rom, 1.7 për qind egjiptian, 0.1 për qind malazezë, ndërsa 22 për qind e tyre nuk janë të kategorizuar. Nga numri i përgjithshëm i bizneseve në pronësi të pakicave etnike, 79 për qind janë në pronësi të burrave dhe 21 për qind të grave", është thënë në raportin e GAP-it.

Ndërsa bizneset në pronësi të grave me jetëgjatësinë më të madhe operojnë në sektorët: tregtia më shumicë dhe pakicë (6.71 vjet), transport dhe magazinim (6.53 vjet). Bazuar në gjetjet e raportit,

Instituti GAP ka rekomanduar që Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë një përkufizim të saktë të asaj që konsiderohet "biznes aktiv" dhe të ofrojë mekanizma për mbledhjen e të dhënave të besueshme në mënyrë që të shmangen mospërputhjet e të dhënave, si në këtë rast ku shifrat e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, nuk përputhen. Të kuptuarit e profileve të bizneseve në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave mund ta ndihmojë qeverinë dhe palët e tjera të interesuara të hartojnë dhe zbatojnë politika dhe programe që mbështesin këto kategori të bizneseve.

Çmimet e energjisë elektrike në Kosovë për vitin 2022, më të lira në rajon dhe Evropë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Sipas Zyrës së Statistikave të Komisionit Evropian (Eurostat), Kosova kishte bindshëm çmimet më të lira të energjisë elektrike në Evropë për vitin 2022, kur edhe janë bërë matjet e fundit vjetore. Çmimet mesatare për shpenzimin mesatar të konsumit janë 6 centë për kilovat/orë që është rreth 25 për qind më lirë se e dyta më e lira, që është Serbia me çmim 7 centë për kilovat/orë. Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi kanë çmimet nga 8 centë për kilovat/orë apo më tepër se 35 për qind më shtrenjtë se në Kosovë. Maqedonia e Veriut është edhe më e shtrenjtë, duke shënuar çmimin prej 10 centësh për kilovat/orë, që i bie rreth 70 për qind më shtrenjtë se Kosova.

Në këto matje janë të përfshirë vetëm konsumatorët e përmasave të mesme me një konsum vjetor prej 2 500 kWh deri në 4999 kWh. Të gjitha vendet e BE-së kanë çmime së paku dyfish më të



larta se Kosova. Vendi më i populluar i BE-së, Gjermania, ka një çmim prej 28 centësh për kilovat/orë apo 4.75 herë më tepër se në Kosovë. Ndërkohë, Danimarka, Belgjika dhe Italia janë tri

vendet e Bashkimit Evropian të cilat vazhdojnë ta paguajnë çmimin më të lartë për energji elektrike bazuar në të dhënat e Eurostatit për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2022. Kurse sa i përket rajonit, çmimet më të

larta të energjisë elektrike për konsumatorët shtëpiakë i kanë Romania, Greqia dhe Kroacia. Sipas Eurostatit, në Danimarkë 1 kilovat/orë energji elektrike kushton mesatarisht 47 centë,

në Belgjikë 42 centë, kurse në Itali 33 centë. Në Kosovë çmimi për kilovat/orë është 6 centë, që i bie se është gati pesëfish më i ulët se në Rumani, ku 1 kilovat/orë kushton 29 centë.

Konfiskohen 30 automjete të pazhdoganura

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Njësitë antikontabandë të Doganës të Kosovës kanë vazhduar të kryejnë kontrolle nëpër territorin e vendit për të parandaluar veprimtarinë e kontrabandës. Gjatë një operacioni janë kryer kontrolle në tri lokacione të ndryshme, me pika thelbësore, një në Xërxë të Rahovecit dhe dy në Carallukë të Malishevë. Dogana ka sekuestruar 30 automjete të pazhdoganura. "Njësitë e

Doganës së Kosovës kanë identifikuar dhe kryer kontrollin e automjeteve me targa të huaja, si dhe kanë gjetur autopjesë pa dokumentacionin e nevojshëm që dëshmon se automjetet nuk janë të zhdoganura. Si rezultat i këtyre kontrolleve janë zbuluar dhe sekuestruar 30 automjete të pazhdoganura si dhe pjesë të automjeteve të paligjshme në këto tri lokacione. Në përputhje me pro-

cedurat ligjore, është filluar procesi i kundërvajtjeve. Dogana e Kosovës ka aplikacionin 'eDogana' për pajisjet e mençura 'Android' dhe 'iOS', i cili mundëson lajmërim të parregullive dhe sjelljeve joprofesionale me komunikim të sigurt dhe ofron shërbime të tjera me qëllim të shërbimit ndaj qytetarëve dhe komunitetit të prodhuesve dhe tregtisë në përgjithësi", ka njoftuar Dogana e Kosovës.



Mos besoni gjithçka që mendoni



Lauren WEINSTEIN

Elefanti ka një forcë të jashtëzakonshme. Ai mund të shkulë një pemë vetëm me këmbën e vet. Megjithatë ai do të mbetet në robëri, i mbajtur vetëm nga një litar i lehtë. Pavarësisht aftësisë së tij për t'u shkëputur kollaj, elefanti as që përpqet.

Pse?

Fillon kur është i ri. Atë e lidhin fillimisht kur është i vogël dhe ende nuk është aq i fortë sa të këpusë litarin. Do të përpqet në fillim, do të përpqet sa më shumë që të mundet për t'u çliruar dhe do të përpqet e do të përpqet, por përfundimisht do të kuptojë se nuk mundet.

Papritur, atij i ngjitet diçka që është më i fortë se çdo litar, zinxhir apo gardh. Është besimi se nuk mund të çlirohet. Është ky besim që e frenon- pavarësisht aftësisë së tij. Unë kam pasur të njëjtat besime – mund të keni edhe ju – besime që më penguan, besime që më shtynë të ndihesha e paplotësuar në punën time, të luftoja në marrëdhëniet e mia dhe të jetoja një jetë që ishte larg asaj që jetoja tani.

Vetëm kur u bëra e vetëdijshme për litarët e mi dhe u mora aktivisht me ta, u gjenda në një realitet tjetër.

SI I KËPUT LITARËT QË TË MBAJNË LIDHUR?

Mos besoni gjithçka që mendoni. Kur isha gjashtë vjeçe, kisha një kujdestare të preferuar, Amber. Një

mëngjes, nëna ime më tha se nuk mund ta mbanim kujdestaren, sepse ajo nuk kishte para për ta paguar.

Kështu që atë pasdite, fillova kompaninë time të parë. Mblodha gurë tek lagjja, i pikturova me kompletin tim të artit dhe shkova derë më derë, duke ua shitur fqinjëve. Atë natë, ishim Amber dhe unë së bashku në divan.

Kur isha e re, isha e guximshme, e hapur dhe e patrembur. Vishja atë që doja ose nuk doja të vishja, e udhëhequr nga zëri im që më thoshte se çfarë do të më bënte të lumtur.

Isha edhe e dashuruar. Ai quhej Fernando dhe ishte i mrekullueshëm. Si me çdo gjë tjetër, nuk kisha frikë ta përqafoja me të dy duart.

Teksa rritesha, kjo "foto" filloi të zbehej. Kurajo im u zëvendësua me ndrojtjen, prirja për udhëheqje ime me konformitetin, guximi im me frikën.

Unë mendoj se asnjë prej nesh nuk e lë fëmijërinë pa disa litarë, pavarësisht qëllimeve më të mira të prindërve tanë. Unë u rrita me një nënë që ishte e vendosur të më ofronte jetën perfekte. E mbushur me dashuri dhe qëllime të mira, ajo bëri gjithçka për mua për të më ndihmuar të jem perfekte.

Unë bëja një valixhe për të shkuar në një udhëtim me shkollën, ajo e shpaketonte dhe e ripaketonte në një mënyrë më të përsosur. Isha gati të merrja pjesë në një projekt artistik të shkollës dhe ajo shtonte në fund goditjet e saj të penelit për ta bërë më të mirë.

Më vonë ajo më tregoi kur zgjedhja ime e të dashurit apo e apartamentit nuk ishte mjaft e

mirë. Edhe pse ajo donte vetëm atë që ishte më e mira për mua, unë vetë pushova së dituri se çfarë ishte më e mira për mua.

U krijua një litar pa ndjenja. Nuk duhet t'i besoja zërit tim dhe aftësive të mia dhe kisha frikë se mos nuk isha e përsosur.

Litarë të tjerë u ngjitën gjithashtu. Jam rritur në një familje të mbushur me të bërtitura, zëra të lartë dhe opinione të forta. Për të ruajtur qetësinë, mësova të hesht, të mos tund varkën, të bëhem e padukshme.

Në shkollë, arrita të besoja se është më e rëndësishme të përzihesh me të tjerët, sesa të spikatësh. Dhe dhimbja e një thyerjeje të hershme zemre më bëri të përmbahem në marrëdhëniet e mia në mënyrë që të mos lëndohem.

Nuk jam e mirë sa duhet. Mos fol. Mos u dallo. Ki frikë nga dështimi. Këto ishin litarët e mi.

Kjo nuk është vetëm historia ime. Ashtu si elefanti, të gjithë ne besojmë në disa gjëra nga fëmijëria, që nuk ishin të vërteta – ose të paktën nuk janë më të vërteta. Por ne ende jetojmë me to, sikur të jenë të tilla.

Nëse jeni ndjerë ndonjëherë jo mjaftueshmërisht mirë, vetëm, të padëshiruar, të padashur, të padukshëm, të pafuqishëm, sikur nuk i përkisni mjedisit ku jeni – këto janë litarët tuaj.

Nëse keni ndjerë ndonjëherë se nuk mund t'i besoni vetes, t'u besoni të tjerëve, të flisni, të shfaqeni, të kërkoni ndihmë, t'i lejoni të tjerët të hyjnë në jetën tuaj, të pranoheni ashtu siç jeni – këto janë litarët tuaj.

Këto litarë na frenojnë.

E gjeta veten duke mos u përballur

me mendimet e të tjerëve kur duhej të kisha besuar të miat, duke qëndruar e heshtur, kur të flisja, a do të më kishte sjellë dobi, dhe duke u përzier me të tjerë, kur do të isha më e lumtur nëse do të kisha guxim të spikatja e vetme.

Kjo më çoi në një sërë punësh që varionin nga të tolerueshme, deri në të mjerueshme. Në njërin prej tyre, shpresoja se do të sëmuresha që të mund të rrija në shtëpi. Më çoi në një sërë marrëdhëniesh në të cilat më mungonte besimi tek vetja, tek tjetri dhe tek marrëdhënia. Këto nuk funksionuan kurrë.

Besimet e mia ndikuan në mënyrën se si e perceptoja botën, gjë që ndryshoi mënyrën se si veproja, gjë që çoi në një profeci vetë-përmbushëse. Ndihesha e vogël dhe bota ime u bë më e vogël. Ajo që ne besojmë ka efekte të fuqishme. Dekada kërkime të psikologjisë sociale e mbështesin këtë. Në një studim të kryer në Kolejin Dartmouth, një plagë e shëmtuar u vendos përmes grimit, në fytyrat e pjesëmarrësve. Më pas ata u dërguan në një dhomë për një bisedë dhe atyre iu kërkua të raportnin se si njerëzit reagonin ndaj tyre, duke parë plagën.

Por këtu ishte "hileja". Pak para se të futeshin në dhomën e bisedës, eksperimentuesi u thoshte: "Prisni një minutë! Thjesht duam të prekim pak plagën."

Në vend që thjesht ta preknin, ata e hiqnin plotësisht. Pra, pa e ditur, pjesëmarrësit hynë në biseda, duke u dukur krejtësisht normalë. Pavarësisht kësaj, ata u kthyen dhe raportuan se sa të sikletshme ishin bisedat, se si njerëzit shmangnin shikimin e plagës së tyre, se kishin

probleme me kontaktin me sy dhe ishin të tensionuar dhe jo rehat në bisedë.

Fakti që besonin se plaga e sajuar ishte ende aty, në fytyrën e tyre, i shtyu të shihnin gjëra që nuk ishin vërtet aty dhe të sajnin domethënie për sjellje të pafajshme.

Ajo që mund të kishte qenë një bisedë krejtësisht normale, u kthye në një bisedë të sikletshme. Besimet e tyre krijuan realitetin e tyre.

Studime të tjera tregojnë të njëjtin efekt. Po theksove identitetin aziatik të një gruaje aziatike përpara një testi matematike, ajo do të performojë më mirë. Po theksove identitetin e saj femëror, ajo do të performojë më keq.

Po drejtove një grup burrash të besojnë se një detyrë atletike është diagnostifikim i inteligjencës sportive, burrat e bardhë performojnë më mirë. Bëjini ata të besojnë se është një diagnostifikim i aftësisë natyrore atletike, meshkujt me ngjyrë dalin më mirë. Jepini dikujt një pallto të bardhë dhe thojini se është pallto laboratorit mjeku, ai do të bëjë më mirë në një detyrë që kërkon shumë fokus dhe vëmendje, sesa kur i thua se është pallto piktori.

Në të gjitha këto raste, të njëjtët njerëz, të njëjtat aftësi, të njëjtat detyra – besime të ndryshme. Dhe në secilin rast, ishte besimi i tyre që rriti ose uli performancën.

Mënyra se si e shihni veten dhe rrethanat tuaja do të ndikojë në atë që shihni, si veproni dhe çfarë ndodh si rezultat. Është pothuajse sikur besimet tona na vendosin një kaskë realiteti virtual, që na lejon të shohim gjëra që nuk janë në të

vërtetë aty dhe na dërgon në një realitet të rremë.

Ne i kemi këto kaska edhe kur ato janë kilometra larg nga e vërteta. Më kujtohet që kam dëgjuar top-modelen Cameron Russell të rrëfente sesi modelet, pavarësisht se kanë flokët më të shndritshme dhe këmbët më të gjata, janë disa nga njerëzit më të pasigurta fizikisht në planet.

Kaskat tona na bëjnë të jetojmë në një realitet të rremë. Ato gjithashtu na bëjnë të përplasemi me njëri-tjetrin.

Një herë, isha lidhur me dikë për disa javë. Le ta quajmë Ben. Flisnim çdo ditë. Më pas ai shkoi në një udhëtim pune. Për katër ditë, heshtje. Nuk dëgjova asnjë fjalë.

Si do ta interpretonit këtë? Cili është mendimi i parë që ju vjen në kokë? Bindjet e mia më shtynë të pyesja veten se çfarë kisha bërë ose thënë për ta bërë këtë person dikur entuziast të ndryshonte mendim për mua.

Heshtjen e tij e ndava me miqtë. Njëra, e cila pranon se e ka të vështirë t'u besojë njerëzve, ishte e sigurt se ishte në këtë udhëtim me një grua tjetër.

Një tjetër, e cila pranon se ka frikë nga refuzimi, mendoi se ai ndoshta ishte i mërzhitur sepse nuk e kisha ftuar të më shoqëronte në një dasmë.

Dhe një i tretë, i cili ka probleme me përkushtimin, mendoi se ndoshta mendonte se po lëviznim shumë shpejt dhe po i linim pak hapësirë njëri-tjetrit.

Secili person pa të njëjtën situatë përmes lenteve të veta. Kush kishte të drejtë? Si duhet të përgjigjem?

Secili prej këtyre supozimeve çon në një përgjigje të ndryshme. Duke lëvizur shumë shpejt? – Duhet të tërhiqem. Por nëse ai ndihet i refuzuar, kjo thjesht do ta lëndonte më shumë.

Ndihet i refuzuar? – Duhet t'i bëj një telefonatë dhe ta ftoj në dasmë. Por nëse ai mendon se ne po ecim shumë shpejt, kjo thjesht do ta largojë më shumë. Isha shumë e hutuar.

Ndërsa po bëja ping-pong me "kaskën" time, ndërsa huazoja disa nga kaskat e miqve të mi, kjo marrëdhënie vdiq në një vdekje të ngadaltë.

A jeni gati për atë që po ndodhte në "kaskën" e Benit? Ai ishte lënduar thellë nga një marrëdhënie e kaluar, kishte frikë se mos lëndohej përsëri dhe u tërhoq kur pasiguritë e tij u shumëfishuan. Nuk ishte asnjë nga gjërat që dikush kishte hamendësuar.

Ndonjëherë "kaskat" tona na pengojnë marrëdhëniet. M'u desh shumë kohë për ta mësuar këtë. Ashtu si besimet tona mund të na pengojnë, ato gjithashtu mund të na shtyjnë përpara.

Le të kthehemi te studimi i plagës për një moment. Imagjinoni të kundërtën. Imagjinoni sikur studiuesit të vendosnin diçka në fytyrat e pjesëmarrësve që i bënte ata të besonin se duken bukur dhe më pas e heqin atë përpara se të shkojnë në mjedisin social. Tani, çfarë mendoni se besojnë ata për reagimet e të tjerëve?

Sa ndryshe mendoni se do sillëshin? Çfarë ndryshimi ka nëse besoni se jeni i shëmtuar apo i bukur, i mirë në matematikë apo i tmerrshëm në të, i mirë në sport apo jo? Duket, një gjë e madhe.

Më në fund e nxorra këtë mësim. "Kaskat" e mia më çuan në fakultetin juridike. Aty u përforcuan besimet e mia prej kohësh të rreme: syno përsosmërinë, ndiq turmën, ki frikë nga dështimi. Kjo ishte një rrugë e njohur.

Pastaj një ditë, pa menduar shumë për këtë, u regjistrova në një klasë jashtë fakultetit juridik, të quajtur Design Thinking Boot Camp, një klasë që premntonte të nxirrte potencialin tim krijues.

Më duhej të projektoja produkte dhe krijoja përvoja inovative, ose më saktë, të tërhiqja pothuajse çdo litër që më mbante lidhur. Më duhej t'i besoja zërit tim, sepse kur bëhet fjalë për inovacionin, definitivisht nuk ka njeri të cilit t'i kërkojsh përgjigje.

Më duhej të shfaqesha vetë, sepse inovacioni nuk vjen duke luajtur në terren të sigurt. Dhe ndoshta më e rëndësishmja, duhej të isha e gatshme të dështoja, të isha e gatshme të mos isha e përsosur. Modelet më të mira erdhën vetëm pas shumë përpjekjeve të dështuara.

Nëse doja ta bëja siç duhet, fillimisht duhej të isha e gatshme ta bëja gabim.

Kam luftuar në këtë klasë, sepse të gjitha gjërat që do të më ndihmonin të kisha sukses ishin të njëjtat gjëra që, prej kaq shumë vitesh, besoja se nuk duhej t'i bëja. Më në fund iu dorëzova qasjes së tyre të çmendur dhe ndodhi gjëja më e mahnitshme. Isha e lirë të shkoja, të luaja, të provoja gjëra, të eksperimentoja – të jetoja siç kisha bërë përpara litarëve.

Ndihesha e lirë në një mënyrë që nuk e kisha ndjerë që kur isha gjashtë vjeç dhe arrita gjëra që nuk do t'i kisha imagjinuar kurrë. Isha e habitur, krenare, e çliruar – dhe e hutuar.

Pyesja veten nëse besimet që më penguan në këtë klasë ishin të njëjtat që më pengonin në pjesë të tjera të jetës sime.

Fara ishte mbjellë. Ndoshta nuk duhet të besoj gjithçka që mendoj. Duhet fikur "kaska" që krijon realitetin e rremë. Për ta hequr, thjesht duhej të kuptoja se e kisha në kokë. Litarët duheshin këputur. Besimet e reja çojnë në veprime të reja.

Në lëvizjen time të parë të guximshme që kur isha gjashtë vjeç, refuzova ofertën për të punuar në një studio ligjore dhe e vendosa veten në një realitet tjetër. Kam eksperimentuar me punë të ndryshme dhe kam marrë përsipër projekte të ndryshme anësore, duke u thënë po, atyre që më parë do t'u kisha thënë jo për shkak të mungesës së përvojës.

Kisha ende frikë nga dështimi dhe kthesat e gabuara, dhe ndonjëherë e bëja. Thjesht nuk e lejoj më që kjo të më ndalojë.

Pastaj një ditë, mora një pozicion 10-javor me kohë të pjesshme, duke stërvitur folësit. U dashurova me këtë punë. Po flasim për dashuri të nivelit Fernando. Duke mos pasur më frikë të kapja gjërat me të dyja duart, vazhdova dhe hapa kompaninë time, duke ndihmuar udhëheqësit të bëhen folës më të fuqishëm dhe të mësojnë një klasë komunikimi në Stanford.

Veçanërisht domethënëse për mua është se tani mund t'u jap të tjerëve atë që kisha humbur për kaq



shumë kohë – një zë më të fuqishëm. Kam thyer edhe litarë të tjerë.

Kur isha e vetëdijshme dhe e turpshme, kurrë nuk mund ta imagjinoja t'ju zbuloja pasiguritë e mia në një skenë të TED Talks. Kjo do të dukej më shumë si një ëndërr e keqe. Megjithatë, ja ku jam.

Ky proces nuk ndodhi brenda natës. Çdo mendim i ri, çdo veprim i ri u ndërtua mbi atë para tij derisa e gjeta veten në një realitet të ri. Unë kam ende litarë që po punoj për t'i këputur. Objektivi im është më i afërt me kalimin e kohës.

Për të arritur atje, i kujtoj vetes sfidën e "marshmallow". Skuadrave prej katër vetash u jepën 20 shkopinj spaghetti, një varg me fije, një rrotull me ngjitës dhe një marshmallow (tip ëmbëlsire e bërë me sheqer, ujë dhe xhelatinë).

Ekipi fitues është ai që mund të ndërtojë kullën më të lartë që mundet në 18 minuta.

Marshmallow duhet të jetë sipër. Kjo sfidë u është dhënë në të gjithë botën studentëve të shkollave të biznesit, avokatëve, CEO-ve, CTO-ve, inxhinierëve.

Cilët mendoni se janë ndër ata që dalin më mirë? Të sapodalët nga kopshti.

Ja pse. Grupet e tjera do të marrin atë që ata mendojnë se dinë, atë që ata mendojnë se është përgjigja e vetme e duhur dhe do të përfundojnë duke e ekzekutuar në drejtimin e gabuar.

Në të kundërt, fëmijët e kopshtit janë të hapur ndaj mundësive të shumta. Ata testojnë opsione të ndryshme, mbledhin informacione duke eksperimentuar derisa gjejnë rrugën më të mirë përpara. Ata argëtohen.

Ajo që na bën kaq të mahnitshëm si fëmijë është se jetojmë në një botë para vendosjes së litarëve. Në një botë përpara "çfarë dihet", ku kemi "çfarë mundet". Në një botë

përpara "nuk mundem", ku ekziston "si mundem?"

Në një botë përpara "irëzohu dhe mos u ngri më", ku biem dhe ngrihemi menjëherë. Në një botë në të cilën asgjë nuk na pengon nga kapaciteti ynë i plotë.

Çfarë ishte klasa e dizajnit për mua, shpresoj që ky fjalim të jetë për ju – mbjellja e një fare që ju bën të vini në dyshim atë që keni pranuar më parë si të vërtetë, që ju bën më të vetëdijshëm për litarët tuaj, që ju ndihmon të shihni se ato ishin gjithmonë në kokën tuaj. Këputini. Pavarësisht se kush jeni apo ku jeni, në këtë moment, ekziston jeta që mund të jetoni nëse këpusni litarët. Ju arrini atje mendim pas mendimi, veprim pas veprimi, derisa një ditë, e gjeni veten në një realitet të ri.

Faleminderit. / Prezantim i mbajtur në TED Talks – Në shqip nga bota.al

Shkëlqimi dhe rënia e dinastisë Medici



Ajo ishte një nga familjet më të pasura dhe më të fuqishme në Evropë. Prej saj dolën 2 mbretëresha, 3 mbretër dhe 4 papë. Si sundimtarët de fakto të Firences për gati 300 vjet, Medicit krijuan bazën e Rilindjes Italiane. Por para se t'a ngrinin perandorinë e tyre, Medici e nisën si fermerë të varfër nga Kafaxhiolo në veri të Toskanës. Nga fundi i shekullit XIII-të, Xhovani di Biçi de Medici e ndryshoi origjinën e përlurur të klanit të tij me themelimin e një banke të suksesshme.

Për të plotësuar statusin e ri, familja trilloi një prejardhje po aq mbresëlënëse. Sipas legjendës së përhapur prej tyre një i afërm i largët me emrin Averardo luftoi si një kalorës kundër Karlit të Madh të Frankëve. Në vitin 1537, Perandori i Shenjtë Romak Karli V i dha zyrtarisht familjes fisnikërinë që ata dëshironin duke themeluar Dukatin e Madh të Toskanës.

Perandoria bankare e familjes Medici do të zgjerohej me shpejtësi, për t'u bërë institucioni më i madh financiar në Evropë, me degë në Napoli, Gjenevë dhe Londër. Lista e gjatë e klientëve të pasur përfshinte edhe Vatikanin, duke krijuar një aleancë të fortë që u solli shumë fitime.

Nën drejtimin e Kozimo de Medicit (djali i Xhovnait), Firence u bë qendra kryesore bankare. Fuqia e tyre ishte e tillë, sa që patën madje edhe "qasje" të drejtpërdrejtë tek Zoti. Në vitet 1500, 4 të afërm të tyre u zgjodhën si Papë, duke filluar me Papën Leonin X në 1513 vitin.

Por drejtimi i Vatikanit prej tij u shoqërua nga skandale dhe një shthurje e paparë. Ishin teprimet tij, ato që çuan drejtpërdrejt tek Reforma Protestante. Ata mbanin lidhje me figurat më të mëdha të shkencës. Kështu Galileo Galilei ishte i punësuar si mësues kujdestar i fëmijëve të kësaj familje.

Si stërmbesa e Lorencos së Madhërishtë, dhe mbesa e Papa Klementit VII, Katerina e de Medici (Katerine e Madhe) ishte një nga gratë më të fuqishme të epokës së saj. Bukuria dhe zgjuarsia e saj, e lejuan të kishte de fakto pushtetin mbi Francën si një bashkëshorte e mbretit, regjente dhe më pas si nënë e 3 mbretërve.

Në moshën 14 vjeçare, Katerina u fejuan me Henrin, djalin e mbretit francez Fransua I, duke çimentuar një aleancë strategjike dhe siguruar linjat e ardhshme mbretërore të gjakut. Ajo lindi 10 fëmijë, përfshirë monarkët Fransua II, Sharli IX dhe Henri III.

Gjithashtu, 2 nga vajzat e saj u bënë mbretëresha, përkatësisht në Spanjë dhe Francë. Ndikimi i Katerinës në shekullin XVI-të – veçanërisht gjatë Luftërave Fetare – e bëri atë një figurë sa të dashur nga disa aq edhe të urreyer nga disa të tjerë.

Pavarësisht sa e meriton apo jo, Kaeterina u fajësua për masakrën e Ditës së Shën Bartolomeut, ku u vranë mijëra Hygenotë. Interesimi i përjetshëm i saj për okulten dhe marrëdhënien e ngushtë me fallxhorin legjendar Nostradamus, vetëm sa ia shtoi reputacionin e saj prej fajtoreshë. Kësaj familje i njihet edhe merita e shpikjes së akullores që njohim sot. Edhe pse shpikja e akullores daton që në Kinën e lashtë, varieteti i butë italian u krijua posaçërisht për familjen Medici. Në njërin nga variantet e historitë, një kasap i quajtur Ruxheri, fitoi një konkurs prestigjioz për krijimin e "pjatës më të pazakontë".

Katerina u magjeps aq shumë nga ëmbëlsira e pazakontë sa që e mori me vete Ruxherin në oborin mbretëror francez në Paris, për të gatuar për dasmën e saj në vitin 1533. Historia tjetër alternative, thotë se akullorja u krijua nga arkitekti i njohur italian Bernardo në vitin 1565.

Mbështetja e madhe e familjes Medici për shkencat humane, luajti një rol të madh në shkularjen në Firence të artistëve më të mirë të Evropës. Mes talenteve ishte edhe një adoleshent premtues nga fshati i vogël toskan Kaprese, të cilin bota e njohu si Mikelanxhelo. Në vitin 1490, 15-vjeçari pranoi ftesën për t'u zhvendosur me banim në Palazzo Medici.

Atje, ai u bë pjesë e familjes së famshme, ndërsa rafinonte aftësitë e tij të pazakonte artistike.

Mikelanxhelo do të merrte 3 porosi nga tre Papë të familjes Medici (Leoni X, Klementi VII dhe Piu IV).

Gjatë asaj periudhe, ai prodhoi disa nga veprat e tij më të mira, si skulptura e Moisiut dhe afresku i tij "Gjykimit të Fundit", që mbulon murin e altarit të Kapelës Sistine. Gjatë mbretërimit të tyre të gjatë, Medicit ishin vazhdimisht vigjilentë, pasi kishin bërë shumë armiq.

Në vitin 1478, familja Paci ndërmoi një grusht shteti për të vrarë princat e familjes Medici, Lorenzo dhe Xhulianon. Edhe pse vëllai i vogël vdiq nga plagët e marra, Lorenzo mbijetoi dhe arriti të vrasë apo dëbojë nga qyteti rivalët e tij.


Një sulm tjetër, këtë herë nga një predikues radikal i quajtur Xhirolamo Savonarola, do të ishte më i suksesshëm. Frati puritan domenikan arriti të merrte kontrollin e Firences në vitin 1497, duke i inkurajuar mbështetësit e tij fanatikë të dignin librat, veprat e artit dhe sende të tjera që konsideroheshin si "kotësi" të liga.

Por një vit më vonë, Savonarola u shkishërua dhe më vonë u ekzekutua me varje. Nëse historia na mëson ndonjë gjë, ajo është se asgjë nuk zgjat përgjithmonë, përfshirë dinastitë. Në vitin 1737, Khan Gastone de Medici vdiq pa lënë asnjë trashëgimtar mashkull, duke i dhënë fund Dukatit të Madh të Toskanës. Megjithatë, motra e tij do të shpëtonte trashëgiminë e familjes.

Ana Maria de Medici, pasardhësja e fundit e drejtpërdrejtë e familjes, firmosi një pakt ligjërish të detyrueshëm, për ruajtjen e veprave të artit në qytetin e Firences. Si rezultat, katedralet dhe muzetë e shumta, si Kapela Medici dhe Galeria Ufici, janë edhe sot të mbushura me thesare të paçmuara.

TopTenz – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Bayerni triumfon ndaj Unitedit, shkëlqen Arsenali

“Epoka e re”

MUNCHEN, 20 SHTATOR - Bayern Munchen e ka fituar ndeshjen kryesore të mërkurën në Ligën e Kampionëve, pasi e mposhti Manchester Unitedin me rezultat 4-3. Ndeshja e zhvilluar në “Allianz Arena” i ka takuar grupit A. Mysafirët nga Anglia ishin dominues në minutat e parë, por me kalimin e minutave skuadra gjermane e mori kontrollin dhe në minutën e 28-të arriti të kalon në epërsi kur shënoi Sane. Katër minuta me vonë, Musiala depërtoi për mrekulli dhe me pas e shërbeu Gnabry, i cili nuk e kishte të vështirë të realizon golin e dytë. Unitedi u rikthye në lojë në fillim të pjesës së dytë duke e ngushtuar rezultatit në 2-1, kur realizoi Hojlund. Pesë minuta me vonë gjyqtari akordoi penallti për Bayernin dhe nga pika e bardhë i saktë ishte Harry Kanë për rezultatit 3-1. Unitedi e realizoi edhe golin e dytë në minutat e



fundit të ndeshjes nëpërmjet Casemiros, por Bayerni realizoi edhe golin e katërt me anë të Telit në minutat shtesë për rezultatit 4-2. Krejt në fund të ndeshjes Unitedi realizoi edhe një herë dhe

sërisht autor i golit ishte mesfushori Casemiro. Nënkampionia e Premier Ligës, Arsenal ka treguar lojë të mirë në ndeshjen ndaj PSV-së, të cilën e ka fituar me rezultat bindës 4-0. Pas

tetë minutave lojë, Saka shënoi për 1-0. Në minutën e 20-të, Saka asistoi për Trossard që shënoi golin e dytë në ndeshje. Jesus shënoi golin e tretë për vendasit në pjesën e parë, derisa në pjesën e

REZULTATET

Galatasaray - FC Copenhagen	2-2
Bayern Munchen - Manchester United	4-3
Arsenal - PSV Eindhoven	4-0
Sevilla - Lens	1-1
Real Madrid - Union Berlin	1-0
SC Braga - Napoli	1-2
Benfica - FC Salzburg	0-2
Real Sociedad - Inter	1-1

dytë shënues ishte edhe Odegaard për rezultatit final 4-0. Në ndeshjen tjetër të grupit B, Sevilla luajti baras me Lensin (1-1). Skuadra e Napolit ka arritur fitore në ndeshjen ndaj Bragës me rezultat 1-2. Realizues të Napolit ishin Lorenzo dhe Niakate (autogol). Për vendasit shënues ishte Bruma. Skuadra tjetër italiane Inter që edicionin e kaluar luajti në finale të Ligës së Kampionëve, sonte nuk arriti me shumë se një barazim 1-1 ndaj Real Sociedad. Për spanjollët shënues ishte Mendez, derisa për italianët shënoi Martinez.

Bardhi Rexha operohet me sukses: Rikthehem edhe më i fortë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Basketbollisti Bardhi Rexha i është operuar me sukses në meniskun lateral, pas lëndimit që ka pësuar në Lojërat Mesdhetare “Heraklion 2023”, në të cilat e ka përfaqësuar Kosovën në garën 3X3. “Dua të konfirmoj se i jam nënshtruar me sukses operimit në meniskun lateral dhe tash jam i fokusuar plotësisht në fazën e rikuperimit. Mezi pres të kthehem në parket edhe më i fortë. Dua ta falënderoj Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) që në mënyrë jashtëzakonisht profesionale e trajtoi rastin tim bashkë me Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK) dhe më qëndroi pranë që nga çasti i parë kur kam pësuar lëndim”, ka thënë Rexha. “Falënderoj mjekët e jashtëzakonshëm të Royal Medical Hospital që mundësuan që operimi të kryhet me sukses dhe që të filloj menjëherë fazën e rikuperimit. Falënderoj edhe Klubin tim KB Vëllaznimi dhe bashkëlojtarët që më kanë ofruar mbështetje maksimale.



Falënderoj familjen dhe shoqërinë! Ju premtoj të gjithëve se do të kthehem më i fortë!”, ka shtuar basketbollisti Rexha.

Maratona ‘Prishtina 2023’ mbahet të dielën

Prishtinë, 20 shtator - Federata e Atletikës e Kosovës (FAK) në konferencën për medie ka dhënë hollësi për Maratonën “Prishtina 2023”. Maratona “Prishtina 2023” do të mbahet më 24 të këtij muaji, respektivisht këtë të diel, në kryeqytet. Kryetari i FAK-ut, Halil Sylejmani, ka thënë se organizimi i kësaj maratone ka filluar para 22 vjetësh dhe nuk është ndalur deri më sot, pasi e ka bërë punën e vet jo vetëm në Kosovë. Ndërkaq, zyrtari për sport në komunën e Prishtinës, Granit Makolli, u shpreh i lumtur që maratona do të organizohet sërisht në kryeqytet, ndërsa e siguroi FAK-un se do ta ketë mbështetjen e plotë nga komuna. Për Fitim Arifin, përfaqësuesin e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), ky edicion i maratonës është shumë i rëndësishëm, pasi është në kohën e lajmit të organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030. Ndërkaq zyrtari për informim, njëherësh anëtar i Kryesisë së Federatës së Atletikës, Adrijan



Mazreku, shpalosi edhe hollësitë e kësaj maratone. Nga kjo maratona do të ketë shpërblime edhe për atletët që zënë tetë vendet e para. Shpërblimet do të jenë për meshkujt dhe për femrat. Shpërblimet për vrapimin Maratonë (42.195 kilometra) te meshkujt dhe femrat: Vendi i parë (1 mijë euro), vendi i dytë (700 euro), vendi i tretë (400 euro), vendi i katërt (200 euro), vendi i pestë (150 euro), vendi i gjashtë (100 euro), vendi i shtatë (70 euro) dhe vendi i tetë (50 euro). Shpërblimet për vrapimin Gjysmëmaratonë (21.0975 kilometra): Vendi i parë (250 euro), vendi i dytë (200 euro), vendi i tretë (150 euro), vendi i katërt (100 euro) dhe vendi i pestë (50 euro).

Dënim i lehtë nga UEFA për Rumaninë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - UEFA e ka marrë vendimin për incidentet që ndodhën në ndeshjen Rumania - Kosovë, e vlefshme për kualifikimet e “Euro 2024”.

Komisioni Disiplinor i UEFA-s e ka dënuar Rumaninë me zhvillimin e një ndeshjeje si vendëse pa shikues, atë ndaj Andorrës, si rezultat i skandalit të

publikut rumun, i cili e shpalosi pankartën “Kosova është Serbi” dhe për thirrjet e tifozëve “Serbia, Serbia”. Ndërsa federata rumune është

gjobitur me 52 mijë euro për parregullsitë që u shfaqën në këtë ndeshje. Ky pa dyshim është një dënim i “butë” për rumunët.



Enrique: Mbappe për mua është lojtari më i mirë në botë

PARIS, 20 SHTATOR - Kylian Mbappe po vazhdon të shënojë për Paris Saint-Germainin, ndërsa e ndihmoi gjigantin francez të fitojë në duel me Borussia Dortmundin në Ligën e

Kampionëve. Nënkampioni i botës në fakt ka numra të frikshëm në Ligën 1 këtë edicion, 7 gola në 4 ndeshje, ndërsa një gol në një ndeshje në Ligën e Kampionëve. E për këtë, ish-

futbollistin e Monacos e ka përgëzuar edhe trajneri Luis Enrique në konferencë për shtyp. "Kylian për mua është lojtari më i mirë në botë. Por, më shumë se kualitetet e tij teknike, ajo që më

ka goditur më së shumti është kualiteti i tij human. Është kënaqësi ta kesh në dhomat e zhveshjes dhe në stërvitje. Është lider gjithmonë me buzëqeshje në fytyrë", ka thënë Enrique.



Rruga drejt 'Euro 2024', Sylvinho: Do ta japim maksimumin

TIRANË, 20 SHTATOR - Kombëtarja shqiptare po kalon një periudhë të artë. Atë e ndajnë vetëm tri përballje nga kualifikimi drejt Evropianit 2024. Një meritë të madhe për këtë ka trajneri Sylvinho, i cili ka kthyer harmoninë në skuadër. Në një intervistë për "Euronews Albania", braziliani ka rrëfyer rrugëtimin te kuqezinjtë, ndërsa është ndalur në disa çështje, mes tyre në atë të Brojës. Sylvinho ka pohuar se është duke e ndjekur nga afër situatën e sulmuesit të Chelseas. "Ne po e ndjekim Brojën nga afër. Ai është shumë pranë për të qenë i gatshëm, por jo 100%. Në këtë mënyrë nuk duam problem as me futbollistin as me klubin. Nëse ai do të jetë i gatshëm, do ta ftojme", ka thënë Sylvinho.



Pavarësisht prej mungesës së tij, grupi po kalon një formë të mirë, ndërsa ka vlerësim maksimal nga tekniku. "Të them të vërtetën, të gjithë futbollistët janë shumë të mirë. Ata që më surprizuan më tepër. Janë ata që luajtën për herë të parë ndaj Polonisë. Shpirti i garës dhe uria për fitore u ndihmon në të tilla nivele", u përgjigj Sylvinho.

Forma e mirë që po kalon Shqipëria, bën që Sylvinho të jetë në qendër të vëmendjes. Kudo që ai shkon qytetarët e përhëndesin, por nuk ngurren t'i japin mendime. "Ndodh në gjithë

botën të ketë përfshirje, është një sport shumë pasionant. Kudo që të shkosh, njerëzit flasin e japin mendime. Presidenti Duka nuk ka ndërhyrë asnjëherë. Është profesionist", ka shtuar Sylvinho, i cili ka filluar të mësojë fjalë të gjuhës shqipe. "Mirëdita, mirupafshim, natën e mirë", janë disa nga fjalët që ai ka mësuar deri më tani.

Tekniku foli edhe për stadiumin "Air Albania". "Stadiumi është në gjendje fantastike dhe është mjaft mirë të luajmë sfida aty".

Në përfundim një mesazh për tifozët kuqez, të cilët ishin më tepër se 23 mijë në përballjen ndaj Polonisë. "Që nga dita e parë kam thënë nuk do të na mungojnë shpirti, zemra dhe dëshira në fushë. Ne do të japim maksimumin".

Shqipëria do të rikthehet në fushën e lojës ndaj Çekisë në shtëpi më 12 tetor, për të vijuar më pas ndaj Moldavisë në transfertë më 17 nëntor, për ta përmbyllur fazën kualifikuese me Ishujt Faroe në Tiranë.

Përballja Usyk - Fury mund të realizohet në dhjetor

LONDËR, 20 SHTATOR - Boksierët Oleksandr Usyk dhe Tyson Fury mund të përballen në një duel që do t'i unifikonte titujt kampionë bote të peshave të rënda para fundit të këtij viti ose në vitin 2024. Këtë gjë e konfirmoi promotori i njohur i boksit, Bob Arum, njëkohësisht menaxher i Tyson Furyt. Arum, kreu i Top Rank, po promovon luftën e ardhshme të kampionit WBC, Fury kundër ish-kampionit të peshave të rënda të UFC, Francis Ngannou. Kjo përballje do të zhvillohet në Arabinë Saudite më 28 tetor. Promotori 91-vjeçar i boksit beson se do të jetë shumë e thjeshtë që Fury të përballlet me ukrainasin Usyk (IBF, WBA, WBO). Për "Sky Sports", Arum ka deklaruar: "Nuk do të jetë e vështirë të bëhet. Unë i njoh njerëzit Usyk. Ata janë njerëz të mirë. Menaxheri i tij, të gjithë ata, ata janë njerëz të mrekullueshëm. Vetë Usyk është një djalë i



mrekullueshëm. Unë mendoj se ai e dëshiron atë sfidë. Mendoj se dueli do të realizohet dhe shpresoj se do të ndodhë më shpejt sesa më vonë". Kur iu kërkua të flasë për një datë, Arum u përgjigj: "Ndoshta në fillim të vitit të ardhshëm, por mund të ndodhë që në dhjetor. Do

të doja ta shihja Furyt të luftonte me Usykun. Mendoj se sapo të ndeshet me Usykun, dhe duke supozuar se mundet Usyk, atëherë mendoj se ai do të bëjë një xhiro fitoreje. Ndoshta edhe dy duele të tjera dhe do t'i lërë djemtë më të rinj ta marrin përsipër".

SHKURT

Superkupa e Femrave zhvillohet më 3 dhe 4 tetor në Prizren

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marrë vendim që më 3 dhe 4 tetor të organizohet Superkupa e Kosovës në konkurrencën e Femrave në Palestrën "Sezai Surroi" në Prizren. Gjithashtu, janë miratuar propozicionet e garave të Ligave të Kategorive të Reja për edicionin 2023/24.

Guardiola: Jemi me fat që e kemi Rodrin

Manchester City nis mbrojtjen e titullit me një fitore me përmbysje përballë Crvena Zvezdas në Ligën e Kampionëve. Mesfushori spanjoll, Rodri, u shpall lojtari i ndeshjes, ndërsa Pep Guardiola foli fjalë të mëdha: "Jemi me fat që e kemi në skuadër. Për mua është mesfushori më i mirë në Evropë. Mund të përmirësohet ende".

Lëndimi i Maignanit nuk është serioz

Portieri francez i Milanit, Mike Maignan, u detyrua ta linte fushën e lojës ndaj Newcastle's pas një lëndimi. Pas ekzaminimeve mjekësore u vërtetua se 28-vjeçari nuk ka pësuar asnjë lëndim serioz dhe pritet të mungojë shumë pak ditë. Maignan do të mungojë në përballjen e mesditës të së shtunës ndaj Veronas, përballje e kjo e vlefshme në Serinë A, teksa pritet që të rikthehet në fushën e blertë, në përballjen e mesjavës së ardhshme ndaj Cagliariarit.

Hummels: Ne dhe gjyqtari nuk ishim në nivel

Borussia Dortmundi pësoi humbje në ndeshjen e parë të Ligës së Kampionëve për edicionin 2023/2024 nga PSG-ja (2-0). Pas kësaj humbje ka reaguar mbrojtësi gjerman Mats Hummels, i cili e pranoi se Dortmundi nuk luajti mirë, por edhe gjyqtari është paraqitur në nivel të dobët. "Performancë e keqe nga ne me një fitore të merituar për PSG-në. Megjithatë gjyqtari nuk ishte në nivel. Shumë vendime të këqija si penalltia. Kështu që ata dhe ne duhet të përmirësohemi për ndeshjen e dytë", ka thënë Hummels.

Presidenti i Tottenhamit: Kane mund të rikthehet një ditë

Presidenti i Tottenham Hotspurit, Daniel Levy, ka zbuluar se golashënuesi më i mirë në historinë e klubit, Harry Kane, mund të rikthehet një ditë në Londër. Opsion që bëhet i mundur si pasojë e një klauzole të veçantë. "Kemi përfshirë një klauzolë riblerjeje të Kanes. Dua ta falënderoj për gjithçka që ka bërë për ne. Harry do të jetë gjithmonë i mirëpritur te Tottenhami. Ai është një nga të familjes, një pjesëtar shumë i dashur dhe i vlerësuar. Do të mbetet gjithmonë në historinë e Tottenhamit", u shpreh kreu i klubit për Kanen, autor i 280 golave në total më skuadrën e Premierë Ligës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arian Durmishaj, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës se mesme te larte "Dr. Xheladin Deda" Mitrovicë.

- Veton Haliti, shpall te pavlefshme dëftesat e vitit të parë, dytë dhe tretë të shkollës se mesme të lartë "Arkitekt Sinani".

- "Furteria Gashi", shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810550906, Mitrovicë.

- Arian Karakashi B.I, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811503350.

- Drita Nimani, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Osman Rama".

- AHB GROUP SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e Tvsh-së me numër: 330403022.

- Lule Milici shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmedin Nixha".

- Blerton Miftari, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "SHABAN IDRIZI".

- Blina Karakashi, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës se 11 të shkollës se mesme "DR. XHELADIN DEDA".

- Endrit Shabani, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "MIGJENI".

- Jeton Hamiti, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1 deri 9 te shkollës fillore "HARUN BEKA", (Ish-shkolla "Bajram Curri")

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

